



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.484/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blërim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik NNP “CTA” SHPK - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: N.P.N “Alping & Arbëri –NS ” sh.p.k- Hajvali, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan”, me nr. të prok: “613-20-2368-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan, më datën: 20.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: NNP “CTA” SHPK-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan”, me nr. të prok: “613-20-2368-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan”, me nr. të prok: “613-20-2368-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan. dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NNP “CTA” SHPK-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues NNP “CTA” SHPK-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 02.07.2020 me nr.484/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan”, me nr. të prok: “613-20-2368-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 6, 7, 10, 59, 60, 61, 69 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 03.08.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimet ankimore kanë të bëjë kundër ofertës së OE të rekomanduar për kontratë N.P.N “Alping & Arbëri –NS” sh.p.k- Hajvali, eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues sqaron lidhur me kërkesën tek Kapaciteti teknik dhe Professional: 9.1&9.2 kërkesën nr. 2 në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë tek lista e stafit profesional dhe lista e stafit teknik eksperti shqyrtues sqaron se ka hasur në emrat e të gjithë stafit të cilët janë pjesë e këtij operatori ekonomik, ku të njëjtit posedojnë diploma dhe certifikata për profesionet e tyre si dhe kontratat dhe disa të tjerët para kontrata ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, sa i përket pretendimit për punëtorin z. Selim Maloku, Naim Thaçi dhe Arton Thaçi të cilët posedojnë certifikata nga kompania AQSCERT, dhe jo nga qendra e licencuar për aftësim profesional siç është kërkuar në dosjen e tenderit nga AK, eksperti shqyrtues sqaron se të njëjtit posedojnë këto certifikata nga kompania AQSCERT, ku vërtetohet se z.Selim Maloku ka marr pjesë në trajnimin me temë “Kurs Trajnimi për Murator” ku kjo certifikatë mban datën e lëshimit 10.01.2019 dhe me numër të protokollit të certifikatës AQS/T/S20442019.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës sqaron se z. Naim Thaçi posedon certifikatë nga kompania AQSCERT, ku vërtetohet se ka marr pjesë në trajnimin me temë “Kurs Trajnimi për Murator”, ku

kjo certifikatë mban datën e lëshimit 10.01.2019 dhe me numër të protokollit të certifikatës AQS/T/S20452019. Ndërsa, z.Arton Thaçi posedon certifikatë nga kompania AQSCERT, ku vërtetohet se ka marr pjesë në trajnimin me temë “Kurs Trajnimi për Murator”, ku kjo certifikatë mban datën e lëshimit 10.01.2019 dhe me numër të protokollit të certifikatës AQS/T/S20462019. Eksperti shqyrtues e konsideron këtë pretendim si të bazuar dhe vlerëson se gjatë rivlerësimit të kërkohen sqarime shtesë nga ana e autoriteti kontraktues lidhur me këto certifikata se a janë sipas dosjes së tenderit më konkretisht si tek pika J. Të dëshmohet me certifikata të lemisë se ndertimit të lëshuara nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional. Për te gjithë punëtorët kërkohen kontratat e punës ose para kontrate për këtë projekt. Autoriteti kontraktues mban të drejtën e verifikimit të Certifikatave të kërkuara. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me librezën e qarkullimit, eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues sqaron lidhur me kërkesën tek “Kapaciteti teknik dhe Professional”: 9.1&9.2 kërkesën nr.3, ku AK ka kërkuar “Kërkesa 3”. Lista e pajisjeve teknike a. Eskavator min (1 copë) b. Kamion min (2 copë) c. Ngarkues me Lopat min (1 copë) d. Cilinder Vibrator min (1 copë) Auto kran min (1 copë) Dëshmia 3. Lista e pasjeve të nënshkruar dhe vulosur nga OE, për automjetet që nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim dhe dëshmitë tjera përkatëse.

Eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë ka hasur në disa marrëveshje-kontrata për shfrytëzimin e mjeteve, në mes të palëve kontraktuese: RAHOVICA COMERCE SHPK Numri Unik identifikues 810165903 Alping NPN Numri Unik identifikues 810881616, dhe në mes të palëve kontraktuese: R&Rukolli SH.P.K Numri Unik identifikues 810618366 Alping NPN Numri Unik identifikues 810881616. Pra, për mjetin Auto Kran të tipi “Potain Poclain” ekziston marrëveshja e lidhur ndërmjet “Alping” dhe R&Rukolli SH.P.K për marrjen në shfrytëzim. Mirëpo, në lidhje me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me mjetin “Auto Kran” me targa të regjistrimit 02-619-AL, ku sipas OE ankues se OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar librezën e qarkullimit me validitet dhe nuk e plotëson kushtin e AK që OE duhet të dorëzojnë, eksperti shqyrtues sqaron se pas kontrollimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me pajisjet apo mjetet e konsorciumit të rekomanduar për kontratë, vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i bazuar për shkak se tek pajisjet e liderit të konsorciumit “Alping” gjendet dokumenti unik doganor në emër të R&Rukolli SH.P.K për mjetin me përshkrimin: “Autokran i përdorur Marka: Potain Poclain, Tipi: 3FA, Ccm:6086, Kë:125, Dyer:2, UlëseL3, Ngjyra: e GJELBER, Diesel, viti i prodh-regj i parë:1990, numri i shasisë: VHX3FAKT200040072”. Po ashtu, duke u bazuar në fotografitë të cilat i ka bashkangjitur OE ankues lidhur me këtë “Auto Kran” shihet që numri i targave të regjistrimit është 02-619-AL dhe për këtë pajisje mungon librezat e qarkullimit ashtu siç pretendon OE ankues. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK e ka eliminuar pa të drejtë lidhur me licencën e gjeodetit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka ngarkuar licencën e gjeodetit Muzafer Mustafa në platformën e E-prokurimit, ku kjo licencë ishte dhënë me datë 27.03.2014 dhe me afat të skadimit 25.03.2019. Kurse, përmes ankesës së parashtruar, OE ankues ka bashkangjitur licencën e po të njëjtit gjeodet me datë të dhënies 27.03.2019 dhe me afat të skadimit 25.03.2024. Eksperti shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar për shkak se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave ka vepruar drejt për shkak se kjo licencë nuk ka pasur validitet ashtu siç ka qenë kërkesa e autoritetit kontraktues.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së, eksperti shqyrtues sqaron se çmimi i ofertës së OE ankues është 184,040.38 euro, ndërsa çmimi i ofertës së OE të rekomanduar për kontratë është 182,569.09 euro. Andaj, duke pasur parasysh pretendimet ankimore të OE ankues janë të bazuara ndaj grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë, atëherë rezulton se AK me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar konform nenit 60 të LPP-së pasi që ky nen ka përcaktuar që kontrata do ti jepet operatorit ekonomik të përgjegjshëm me çmim më të lirë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa AK me rastin e vlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime shtesë sikurse në pretendimet e OE ankues.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 04.08.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 05.08.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 20.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjitha parashtrësat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues NNP “CTA” SHPK – Prishtinë që ka të bëjë kundër ofertës së OE të rekomanduar për kontratë N.P.N “Alping & Arbëri –NS” sh.p.k- Hajvali, Paneli Shqyrtues

konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me kërkesën tek Kapaciteti teknik dhe profesional: 9.1&9.2 kërkesen nr. 2 në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë tek lista e stafit profesional dhe lista e stafit teknik, gjenden emrat e të gjithë stafit të cilët janë pjesë e këtij operatori ekonomik, ku të njëjtit posedojnë diploma dhe certifikata për profesionet e tyre, si dhe kontratat dhe disa të tjerë parakontrata ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Sa i përket pretendimit për punëtorin z. Selim Maloku, Naim Thaçi dhe Arton Thaçi të cilët posedojnë certifikata nga kompania AQSCERT, dhe jo nga qendra e licencuar për aftësim profesional, siç është kërkuar në dosjen e tenderit nga AK, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se të njëjtit posedojnë këto certifikata nga kompania AQSCERT, ku vërtetohet se z. Selim Maloku ka marr pjesë në trajnimin me temë “Kurs Trajnimi për Murator”, ku kjo certifikatë mban datën e lëshimit 10.01.2019 dhe me numër të protokollit të certifikatës AQS/T/S20442019. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se z. Naim Thaçi posedon certifikatë nga kompania AQSCERT, ku vërtetohet se ka marr pjesë në trajnimin me temë “Kurs Trajnimi për Murator”, ku kjo certifikatë mban datën e lëshimit 10.01.2019 dhe me numër të protokollit të certifikatës AQS/T/S20452019. Ndërsa, z. Arton Thaçi posedon certifikatë nga kompania AQSCERT, ku vërtetohet se ka marr pjesë në trajnimin me temë “Kurs Trajnimi për Murator”, ku kjo certifikatë mban datën e lëshimit 10.01.2019 dhe me numër të protokollit të certifikatës AQS/T/S20462019. Pra, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues e konsideron këtë pretendim si të bazuar dhe vlerëson se gjatë rivlerësimit të kërkohen sqarime shtesë nga ana e autoriteti kontraktues lidhur me këto certifikata se a janë sipas dosjes së tenderit, më konkretisht si tek pika J. Të dëshmohet me certifikata të lemise se ndertimit të leshuara nga **Qendrat e licencuara per aftesim profesional**. Për te gjithë punëtorët kërkohen kontratat e punës ose parakontrate per kete projekt. Autoriteti kontraktues mban të drejtën e verifikimit te Certifikatave te kerkuara. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues NNP “CTA” SHPK – Prishtinë që ka të bëjë me librezën e qarkullimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me kërkesën tek “Kapaciteti teknik dhe Professional”: 9.1&9.2 kërkesën nr.3, ku AK ka kërkuar “Kërkesa 3”. Lista e pajisjeve teknike a. Eskavator min (1 copë) b. Kamion min (2 copë) c. Ngarkues me Lopat min (1 copë) d. Cilinder Vibrator min (1 copë) Auto kran min (1 copë) Dëshmia 3. Lista e pasjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, për automjetet qe nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve, OE duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim dhe dëshmitë tjera përkatëse. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë ka hasur në disa marrëveshje-kontrata për shfrytëzimin e mjeteve, në mes të palëve kontraktuese: RAHOVICA COMERCE SHPK Numri Unik identifikues 810165903 Alping NPN Numri Unik identifikues 810881616, dhe në mes të palëve kontraktuese:

R&Rukolli SH.P.K Numri Unik identifikues 810618366 Alping NPN Numri Unik identifikues 810881616. Pra, për mjetin Auto Kran të tipi “Potain Poclain” ekziston marrëveshja e lidhur ndërmjet “Alping” dhe R&Rukolli SH.P.K për marrjen në shfrytëzim. Mirëpo, në lidhje me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me mjetin “Auto Kran” me targa të regjistrimit 02-619-AL, ku sipas OE ankues se OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar librezën e qarkullimit me validitet dhe nuk e plotëson kushtin e AK që OE duhet të dorëzojnë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas kontrollimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me pajisjet apo mjetet e konsorciumit të rekomanduar për kontratë, vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i bazuar për shkak se tek pajisjet e liderit të konsorciumit “Alping” gjendet dokumenti unik doganor në emër të R&Rukolli SH.P.K për mjetin me përshkrimin: “Autokran i përdorur Marka: Potain Poclain, Tipi: 3FA, Ccm:6086, Kë:125, Dyer:2, UlëseL3, Ngjyra: e GJELBER, Diesel, viti i prodh-regj i parë:1990, numri i shasisë: VHX3FAKT200040072”. Po ashtu, duke u bazuar në fotografitë të cilat i ka bashkangjitur OE ankues lidhur me këtë “Auto Kran” shihet që numri i targave të regjistrimit është 02-619-AL dhe për këtë pajisje mungon librezë e qarkullimit, ashtu siç pretendon OE ankues. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP “CTA” SHPK – Prishtinë se AK e ka eliminuar pa të drejtë lidhur me licencën e gjeodetit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka ngarkuar licencën e gjeodetit Muzafer Mustafa në platformën e E-prokurimit, ku kjo licencë ishte dhënë me datë 27.03.2014 dhe me afat të skadimit 25.03.2019. Kurse, përmes ankesës së parashtruar, OE ankues ka bashkangjitur licencën e po të njëjtit gjeodet me datë të dhënies 27.03.2019 dhe me afat të skadimit 25.03.2024. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar për shkak se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave ka vepruar drejt për shkak se kjo licencë nuk ka pasur validitet ashtu siç ka qenë kërkesa e autoritetit kontraktues.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e OE ankues NNP “CTA” SHPK – Prishtinë se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se çmimi i ofertës së OE ankues është 184,040.38 euro, ndërsa çmimi i ofertës së OE të rekomanduar për kontratë është 182,569.09 euro. Andaj, duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të OE ankues janë të bazuara ndaj grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë, atëherë rezulton se AK me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar konform nenit 60 të LPP-së pasi që ky nen ka përcaktuar që kontrata do ti jepet operatorit ekonomik të përgjegjshëm me çmim më të lirë.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së . Andaj, obligohet AK që gjatë ri-vlerësimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë

konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe ti ketë parasysh kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe kërkesat e dosjes së tenderit me qëllim të vlerësimit të drejtë të ofertave. Po ashtu, Paneli Shqyrtues i sqaron AK-së se duhet të ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Në anën tjetër, autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Lipjan

1x1 OE – NNP “CTA” SHPK-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.